

**RAMI MEMUSHAJ**

**NDIHMESAT E PROF. DR. JORGJI GJINARIT NË LËMIN E  
FONETIKËS SË SHQIPES**

1. Kërkimet fonetike në fushë të shqipes janë relativisht të reja krahasuar me ato në fushë të morfologjisë dhe të sintaksës. Është e vërtetë se njohuri për sistemin tingullor të gjuhës sonë jepen që në gramatikat e para dhe se këto njohuri vijnë duke u shtuar në gramatika si ajo e I. D. Sheperit apo e K. Cipos, por përshkrimet e para fonetike të shqipes i gjejmë në studimet dialektore. Dhe ndër dialektologët që kanë kontribuar më shumë në këtë drejtim është pa dyshim prof. Jorgji Gjinari, i cili një pjesë të qenësishme të veprimtarisë së vet kërkimore-shkencore ia kushtoi fonetikës. E nisi punën në vitin 1956 pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë si dialektolog dhe po atë vit përgatiti artikullin e parë “Një vështrim mbi të folmet e Oparit”, të botuar më 1957 në numrin e parë të Buletinit të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe e kulmoi më 1990, me veprën madhore *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, hartimin e të cilit e udhëhoqi vetë që nga fillimi e deri në fund. Pra, një periudhë 40-vjeçare pune të përkushtuar në terren, në zyrë dhe në auditor, që e bën të shquhet si dialektologu shqiptar me ndihmesat më të spikatura në studimin e dialekteve të shqipes.

Në punën për përshkrimin e të folmeve, dialektologët tanë punuan me një pasion të rrallë. Por pasioni nuk do të mjaftonte për arritjet në këtë fushë, në qoftë se në punën e tyre nuk do të mbështeteshin në një metodologji të rreptë të kërkimit shkencor. Dhe metodologjia e ndjekur prej tyre është e ngjashme me atë të ndjekur nga deskriptivistët amerikanë, ndonëse jemi të mendimit se gjuhëtarët tanë nuk e kanë pasur mundësinë të njiheshin me parimet e kërkimit shkencor të këtij drejtimi gjuhësor. Për ta mbështetur këtë hipotezë tonën, mjafton të kujtojmë se deskriptivistët amerikanë qenë të parët që ndoqën procedura të rrepta kërkimi. Për ta analiza gjuhësore duhet të niste nga tingujt, sepse, si empiristë që ishin, rrjedha fonetike e regjistruar përbënte për ta të vetmen të dhënë fizike objektive që mund të shërbente si pikënisje e sigurt për analizën gjuhësore.

Ky korpus të dhënash të regjistruara në terren duhet t’i nënshtrohej një analize me tri faza: *segmentimi*, ndarja e rrjedhës së ligjëritimit në njësi tingullore bazë (fjali, morfe, fone); *identifikimi* i varianteve të zbuluara në

secilin nivel, d.m.th. bashkimi i tyre në invariante dhe *klasifikimi* i invarianteve<sup>1</sup>.

Por, edhe pa i njohur deskriptivistët, në punën e tyre kërkimore-studimore dialektologët tanë u janë përmbajtur me rreptësi etapave të mësipërme të përshkrimit shkencor. Ata e mblodhën korpusin e analizës në terren, duke e regjistruar në bllok ose në shirit magnetik, duke i dëgjuar mirë me vesh e duke i verifikuar në vend të dhënat e mbledhura. Pastaj të dhënat e mbledhura në terren ia nënshtruan një analize të hollësishme, duke bërë ndarjen e njërive, identifikimin e varianteve dhe klasifikimin e tyre. Ndjekja me rreptësi e këtyre procedurave të analizës gjuhësore, ka siguruar saktësinë e fakteve dialektore të vrojtuarra dhe besueshmërinë në përfundimet e nxjerra, duke i bërë ato një pasuri të vyer në fondin e gjuhësisë sonë që po u lihet trashëgim brezave të ardhshëm të gjuhëtarëve. Në këtë mënyrë, dialektologët tanë kanë punuar me lëndë gjuhësore të folur, të grumbulluar prej vetë atyre në terren, duke ndryshuar nga gjuhëtarët e brezit të sotëm, që si objekt studimi kanë tekstet e shkruara.

2. Studimet kushtuar të folmeve e grupeve të të folmeve, botuar këtu, në Kosovë e në Maqedoni, kanë sjellë ndihmesa me vlerë edhe në ndriçimin e anës fonetike të gjuhës shqipe. Dialektologët tanë kanë punuar si fonetikanë të vërtetë, kështu që pjesët kushtuar përshkrimit të sistemeve fonetike të të folmeve të shqipes mund të themi pa e tepruar se janë punime të vërteta fonetike.

Për ndihmesat në këtë fushë veçohet prof. Jorgji Gjinari, jo vetëm me përshkrimet e aspektit fonetik të të folmeve që ka bërë objekt studimi, po sidomos me një seri shkrimesh për çështje të fonetikës së shqipes, të botuara në revistat gjuhësore “Studime filologjike”, “Gjurmime albanologjike” e në përmbledhje studimesh. Ndër kontributet fonetike të tij do të dallonim tri grupe tematikash: përshkrime të sistemeve fonetike të të folmeve; shkrime kushtuar zhvillimeve historike të sistemeve dialektore dhe të shqipes së përbashkët; dhe shkrime kushtuar problemeve fonetike të gjuhës letrare. Si shkrime të grupit të parë do të përmendim: “Diftongjet *ua/ue, ie* dhe *ye* në të folmet e gjuhës shqipe” (1968), “Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare” (1977), “Sistemi i fonemave zanore të dialekteve të gjuhës shqipe” (1983). Ndër shkrimet për problemet e zhvillimeve fonetike historike në dialektet, do të përmendim “Për zhvillimin e grupeve *kl, gl* në të folmet e gjuhës shqipe” (1971), “Zanoret hundore të gegërishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes”

<sup>1</sup> Shih: Z. S. Harris (1951), *Structural linguistics*, The University of Chicago Press, Chicago & London, 1963, 366–367; shih edhe: R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, shblu, Tiranë, 2003, f. 38.

(1981), “Vështrim i përgjithshëm mbi ndryshimet në sistemin e fonemave të dialekteve të shqipes gjatë historisë së tyre” (1986) etj. Mjaft punime të tjera merren me shqyrtimin e dukurive fonetike të shqipes letrare, si: “Mendime mbi trajtimin e shndërrimeve fonetike në ‘Gramatikën e gjuhës shqipe’” (1969) e ndërrime tingujsh në gjuhën letrare shqipe” (1971), “Mbi parashtesën *sh-/ç-* të gjuhës letrare shqipe” (1972) etj.

Nga këto shkrime duket se rrethi i interesave shkencorë të prof. J. Gjinarit në fushën e fonetikës është mjaft i gjerë. Duke mos u kufizuar vetëm në përshkrimin sinkronik të sistemeve fonetike të të folmeve që ka studiuar, ai është marrë edhe me zhvillimet historike të anës fonetike të shqipes, me trajtimin e dukurive fonetike të shqipes standarde si dhe me lidhjen e aspektit fonetik të gjuhës standarde me drejtshkrimin e saj. Këta interesa i shohim të shfaqen që në periudhën e parë të veprimtarisë së tij shkencore. Kështu, qysh më 1965, në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike, prej tij kemi një diskutim rreth kumtesës së A. Dodit për diftongjet e shqipes, në të cilin bën një varg vërejtjesh rreth pohimeve të autorit të kumtesës, si ajo për shkallën e rregjimit të tingullit [i] në diftongjet, për nevojën e përcaktimit të statusit në të folmet e shqipes të diftongjeve të mirëfillta dhe jo të atyre që krijohen nga bashkimi i zanoreve fundore të temës me mbaresa vokalike a që nisin me zanore. Ai nuk pajtohet edhe me mendimin e autorit të kumtesës për tërheqjen e theksit apo se diftongjet e monoftonguara kanë kaluar më parë në togje zanoresh<sup>2</sup>.

3. Aspekti fonetik i dialekteve të shqipes ka qenë ndër fushat kryesore të interesave shkencorë të prof. J. Gjinarit. Rezultatet e kërkimeve në terren ai i ka pasqyruar në shkrimet për të folmet e ndryshme; por numri më i madh i shkrimeve të tij janë analiza dhe përgjithësime të studimeve dialektore të botuara prej dialektologësh të tjerë. Këto përgjithësime për sistemet tingullore dialektore, në një formë shumë të përmbledhur, i gjejmë në punime të veçanta, në kreun e fonetikës të tekstit universitar “Dialektologjia shqiptare” dhe në kreun e fonetikës të monografisë “Dialektet e gjuhës shqipe”<sup>3</sup>.

Studimet fonetike të prof. J. Gjinarit u ngjajnë pjesëve të një mozaiku, që, po të bashkohen, na japin pamjen e gjendjes aktuale të sistemeve fonologjike dialektore, por edhe me përpjekje tepër serioze për ndriçimin e historisë së zhvillimit të tyre. Të marra në tërësinë e tyre, ato përbëjnë një monografi për sistemin fonemor të dialekteve të shqipes, që në formën më të plotë e gjejmë në librin “Dialektet e gjuhës shqipe”, si kreun e dytë të saj.

<sup>2</sup> J. Gjinari, *Diskutim rreth kumtesës së A. Dodit “Diftongjet e shqipes së sotme nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike”* në “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965, f. 372–374.

<sup>3</sup> J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 92–242.

Ndër këto studime, dy më kryesoret janë “Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare” (1977) dhe “Sistemi i fonemave zanore të dialekteve të gjuhës shqipe” (1983). Këto dy punime monografike merren me përshkrimin e gjendjes së sotme të sistemit fonologjik të dialekteve të shqipes me inventarin e fonemave, me organizimin e tyre në sistem, me funksionet, me variantet fonetike, duke synuar të vihen në dukje njësia dhe dallimet e dialekteve të gjuhës shqipe në sistemin zanor dhe bashkëtingëllor.

Ndër punimet kushtuar përshkrimit fonetik të dialekteve të shqipeve, themelore janë dy punimet për sistemin e fonemave bashkëtingëllore dhe të fonemave zanore të dialekteve të shqipes, që mund të shihen si dy pjesë të një monografie, të cilat kanë shërbyer edhe si bazë për kreun e fonetikës në tekstin e dialektologjisë dhe në monografinë “Dialektet e gjuhës shqipe”. Sikurse vë në dukje autori, në këta artikuj për aspektin fonetik, ashtu si në të gjitha studimet dialektore të kryera të paktën deri në fund të viteve ’80, sistemi konsonantik dhe ai vokalik nxirren nga tërësia e sistemeve të të folmeve të shqipes ashtu si paraqiteshin te brezi i vjetër i folësve<sup>4</sup>. Në punimin për bashkëtingëlloret, “fonemat janë parë njëherazi në prerjen e sotme kohore dhe në planin diakronik... duke u ndalur te pika e nisjes dhe te pika e mbërritjes së dukurisë”<sup>5</sup>.

Në punimin kushtuar zanoreve përshkruhen me radhë inventari i fonemave zanore të shqipes së përbashkët, duke dalluar në të tri seri: të zanoreve gojore të shkurtra, të zanoreve të gjata të zanoreve hundore; më tej përshkruhen sistemet e fonemave zanore sipas pranisë së korrelacioneve, duke dalluar tri areale, sistemet e të cilave jepen me hollësi; një vend të rëndësishëm në këtë artikull të gjatë u jepet funksioneve të fonemave zanore, varianteve të tyre dhe dallimeve dialektore në përbërjen fonemore të fjalëve. Një trajtim të hollësishëm u bën autori në një punim të veçantë edhe zanoreve hundore të gegërishtes, duke i parë ato jo vetëm nga pikëpamja e gjendjes së sotme në areale të ndryshme dialektore, po dhe e historisë së tyre.

Dallimet e dialekteve, të nëndialekteve dhe të grupeve të të folmeve të shqipes prof. J. Gjinari i ka paraqitur së pari në tekstin universitar “Dialektologjia shqiptare”. Duke i klasifikuar këto dallime sipas kriterit strukturor e funksional, ai tregon që “copëzimi dialektor i shqipes nuk është aq i madh sa duket nga pikëpamja fonetike”<sup>6</sup>, d.m.th. se uniteti i të folmeve të

<sup>4</sup> J. Gjinari, *Sistemi i fonemave zanore të dialekteve të gjuhës shqipe*, SF, 1983, 2, f. 51.

<sup>5</sup> J. Gjinari, *Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare*, SF, 1977, 4, f. 3–28.

<sup>6</sup> J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 35.

shqipes është më i madh nga sa mendohet. Kjo mënyrë vështrimi i ka lejuar autorit të shohë dallimet fonologjike (dallime të inventarit dhe të sistemit të fonemave), dallime të funksionet të fonemave dhe, më në fund, dallime në përbërjen fonetike të së njëjtës fjalë. Në këtë mënyrë shihen në fillim zanoret dhe pastaj bashkëtingëlloret e arealeve të ndryshme dialektore të shqipes, duke arritur që në rreth 30 faqe të jepet një pamje e qartë e aspektit fonetik të të folmeve të shqipes.

Po një trajtim shterues u bëhet dukurive fonetike dialektore në monografinë “Dialektet e gjuhës shqipe” (1989), që është kurorëzim i punës 40-vjeçare të autorit në lëmin e dialektologjisë. Në kreun III të kësaj monografie “Sistemi fonologjik në dialektet e gjuhës shqipe”, që zë 150 faqe, sa një monografi e tërë. Ky krye paraqet një sintezë të studimeve dialektore të shqipes në gjysmën e dytë të shekullit që shkoj mbi sistemet fonetike dialektore të shqipes. Në të, autori pajtohet me mendimin e shprehur nga autorë të tjerë se gjuha shqipe ka vetëm dy shkallë gjatësie shqipe dhe se “melodia nuk është karakteristikë themelore për vokalizmin e gegërishtes”, d.m.th. për vokalizmin e shqipes së përbashkët themelore janë “dallimet kuantitative (sasiore), kurse dallimet e tjera janë irrelevante nga pikëpamja fonologjike”<sup>7</sup>. Autori e studion anën fonetike të dialekteve “me metodën strukturore duke i analizuar në aspektin funksional”. Sipas autorit, një mënyrë e tillë vështrimi “bën që veçoritë dialektore të shihen më mirë në sistem, ...me vlerat e tyre funksionale brenda sistemeve përkatëse dialektore”<sup>8</sup>. Për analizën në aspektin funksional autori shpjegon se është mbështetur në klasifikimin e N. Trubeckoit të dallimeve fonetike në tri grupe: dallime fonologjike, dallime fonetike dhe dallime fonetike e etimologjike, si dhe në skemat dhe formulat e përdorura nga A. Martineja për krahasimin tipologjik të gjuhëve<sup>9</sup>. Në përputhje me këtë klasifikim, bëhet edhe përshkrimi i sistemit të fonemave zanore të arealeve dialektore të shqipes, duke dhënë në fillim inventaret e tyre (areale vetëm me serinë e zanoreve të gjata; areale me serinë e të gjatave dhe të shkurtrave; dhe areale me tri seri: zanore të gjata, të shkurtra dhe hundore. Numri i serive të një sistemi vokalik përcakton edhe praninë e korrelacioneve. Nisur nga prania e korrelacioneve, Gjinari i studion të folmet e gjuhës shqipe sipas tri arealesh: areale pa korrelacione, areale me një korrelacion dhe me dy korrelacione. Analiza e sistemeve vokalice vijon

---

<sup>7</sup> J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, f. 97. Që faktori kryesor në vokalizmin e shqipes është gjatësia e zanoreve, ndërsa forca dhe melodia janë dytësore, është pohuar edhe nga studime të tjera të mëvonshme të prozodisë së Ballkanit (shih, p.sh., T. M. Nikolaeva, *Prosodija Balkan*, Indrik, Moskva, 1996, f. 113–114).

<sup>8</sup> J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, f. 98.

<sup>9</sup> Po aty, f. 98.

më tej me funksionet e fonemave dhe, më në fund, me variantet fonetike të fonemave.

Gjithsesi, nga paraqitja e sistemeve fonemore të arealeve dialektore gege e toske, zbulohet se të gjitha arealet kanë të përbashkët serinë e zanoreve johundore dhe jo të shkurtra, d.m.th. një minimum fonemash zanore, që përbëjnë sistemin zanor të gjuhës standarde.

Të njëjtat kritere ndjek autori edhe për bashkëtingëlloret, duke nisur me inventarin e përgjithshëm të tyre në variantet dialektore të shqipes, të cilat i ndan në 9 areale që dallojnë prej njëri-tjetrit nga prania ose mungesa e fonemave të veçanta. Organizimin e fonemave në sistem e bazon në dy tipare korrelative, të mënyrës së formimit dhe të zëshmërisë, sipas të cilëve formohen dy çifte bashkëlidhesh dhe katër seri fonemash konsonantike. Fonemat që përfshihen në këto korrelacione përbëjnë bërthamën e sistemit konsonantik, kurse fonemat e tjera mbeten në skajet e sistemit dhe pikërisht fonemat: /m/, /n/, /N/, /nj/, /h/, /j/, /l/, /ll/ dhe /r/ e /rr/. Në këtë pikë vërehen disa mospajtime me autorët e tjerë që janë marrë me sistemin bashkëtingëllor të shqipes, si rrjedhim i të cilave bërthama e sistemit konsonantik del mjaft e rrudhur. Së pari, autori hundoret /m/, /n/, /N/, /nj/ i vendos në skajet e sistemit, sepse “nuk mund të hyjnë në korrelacion me mbylltoret e zëshme e të shurdhëta”, duke qenë se dallohen prej tyre “nga dy tipare, nga sonoriteti dhe hundorësia”<sup>10</sup>; po kështu, nuk përfshin në bërthamën e sistemit edhe laringalen /h/, dhe sonanten /j/, duke thënë për të parën se “është laringale për nga vendi i formimit dhe në përgjithësi nuk këmbëhet me ndonjë fonemë tjetër të sistemit”<sup>11</sup>; kurse për sonanten /j/ as nuk e vë në diskutim statusin e saj si fonemë skajore. Në të vërtetë, fonema skajore të shqipes së përbashkët janë vetëm anësoret /i/ e /ll/ dhe dridhëset /r/ e /rr/, ndërsa laringalja /h/, /sonantja /j/ dhe hundoret përfshihen në bërthamën e sistemit. Fonemën /h/ A. Dodi, R. Ismajli dhe B. Beci e përfshijnë në bërthamën e sistemit në serinë e shtegoreve të shurdhëta, ku formon një tufë bashkëlidhëse treshe me velaret /k/ e /g/. Përsa u përket hundoreve, karakteri i tingullt i tyre nuk duhet marrë si tipar tipar relevant (dallues), që i dallon këto prej mbylltoreve të zëshme gjegjëse. Për fonologjinë, dallimi të zëshme – të tingullta nuk ka vlerë, d.m.th. këto dy klasa bashkohen në një grup të vetëm, në grupin e fonemave bashkëtingëllore të zëshme, që i kundërvihet grupit të fonemave të pazëshme

<sup>10</sup> Po aty, f. 163. Në këtë pikë autori nuk pajtohet me R. Ismajlin, i cili si korrelacion të tretë pranon atë të hundorësisë, që formohet nga seria e hundoreve dhe e mbylltoreve të zëshme dhe të shurdhëta (R. Ismajli, *Ndërlidhëri kundërvëniesh të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, Përparimi, Prishtinë, 1973, 1, f. 33). Në të vërtetë, në korrelacion me hundoret hyjnë vetëm mbylltoret e zëshme, ndërsa të shurdhëtat jo, sepse dallojnë në dy tipare nga hundoret.

<sup>11</sup> J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, f. 163.

sipas tiparit të zëshmërisë. Pra, hundoret /m/, /n/, /nj/ e /N/ janë të zëshme, që do të thotë se nga mbylltoret e zëshme /b/, /d/, /gj/ dhe /g/ nuk dallojnë në dy tipare, po vetëm në *një*: në tiparin e hundorësisë, që shërben si tipar bashkëlidhës i këtyre çifteve të kundërvënieve mungesore: të parat si hundore, të dytat si johundore. Në këtë mënyrë, këto dy klasa tingujsh formojnë një bashkëlidhje të tretë, bashkëlidhjen e hundorësisë.

E njëjta gjë vlen edhe për fonemën /j/, e cila lidhet me mesgjuhoret /q/ e /gj/ jo vetëm për shkak të tiparit të vendit të formimit, por edhe se hyn në kundërvënie me /gj/-në sipas tiparit të zëshmërisë<sup>12</sup>.

Edhe më e madhe është ngjashmëria e arealeve dialektore në sistemin konsonantik. Nga inventari i përgjithshëm prej 38 fonemash bashkëtingëllore, të gjitha arealet dialektore të shqipes kanë të përbashkëta 29 bashkëtingëllore, të cilat formojnë sistemin bashkëtingëllor të shqipes standarde. Nga këto, sipas autorit, 19 fonema përbëjnë bërthamën e sistemit, kurse dhjetë të tjerat skajet e tij. Pra, dallimet midis të folmeve të shqipes lidhen me inventarin e bashkëtingëlloreve. Njësinë e varianteve të gjuhës shqipe në sistemin bashkëtingëllor, thotë autori, e xjerr më mirë organizimi i tyre në sistem. Këtë njësi autori e sheh, së pari në atë që “Kudo janë të njëjtat fonema që bëjnë pjesë në sistem dhe gjithashtu kudo janë të njëjta ato që qëndrojnë në skajet e sitemit” dhe, së dyti, në atë që “fonemat, në bazë të kundërvënies për nga mënyra e formimit, hyjnë kudo në të njëjat korrelacione”: të zëshmërisë dhe të mënyrës së formimit<sup>13</sup>. Pavarësisht se, sikundër u vërtetua më sipër, autori përfshin më pak fonema bashkëtingëllore në bërthamën e sistemit, më pak korrelacione dhe më shumë fonema skajore, kjo nuk i bën më të ndryshme sistemet bashkëtingëllore të arealeve dialektore të shqipes.

Përshkrimi i sistemeve zanore e bashkëtingëllore të arealeve dialektore të shqipes ka rëndësi jo vetëm për dialektologjinë, por edhe për gjuhësinë normative, sidomos për sa u përket diskutimeve për gjuhën standarde shqipe. Kështu, prania në sistemet fonemore të të gjitha arealeve e serisë së zanoreve gojore të arealeve pa korrelacione dhe i 29 fonemave bashkëtingëllore të përbashkëta, që formojnë sistemin fonemor të shqipes standarde, i hedh poshtë mëtimet se bartës të të folmeve të caktuara e kanë të vështirë ta përvetësojnë këtë sistem fonemor. Edhe folësit e arealeve me sistemet zanore e bashkëtingëllore më të pasura nuk ndiejnë asnjë vështirësi në përvetësimin e sistemit fonemor të gjuhës standarde, për shkak se fonemat

<sup>12</sup> Para nesh, në bërthamën e sistemit bashkëtingëllor e kanë përfshirë fonemën /j/ edhe R. Ismajli e B. Beci (shih: R. Ismajli, *Fonemat marginale të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, Përparimi, Prishtinë, 1973, 5, f. 442; B. Beci, *Mbi disa veçori fonetike të të folmeve të gjuhës shqipe në përfaqje me gjuhën letrare*, SF, 1982, 4, f. 69).

<sup>13</sup> J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, f. 162.

zanore e bashkëtingëllore të saj përbëjnë bazën e sistemeve fonemore dialektore.

Veprimtaria shkencore e prof. J. Gjinarit kulmon me *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe* në dy vëllime, i cili përbën një rëndësi të madhe në studimin e gjuhës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit që shkoi. Si autor, kryeredaktor dhe autor kryesor i kësaj vepre, hartimi i së cilës zgjati 11 vjet (1979–1990), ai, veç drejtimit të përgjithshëm shkencor dhe organizativ, ka punuar në të gjitha proceset. Roli i J. Gjinarit në hartimin e kësaj vepre madhore në fushë të dialektologjisë, duket edhe nga vëllimi punës së bërë dhe nga materialet e hartuara prej tij ose që kanë dorën e tij, duke përfshirë punën përgatitore për *Atlasin* (prospekti i “Kritereve të përgjithshme teorike të ADGjSh-së”, anketimet në terren e skedimet e të dhënave) dhe lëndën e *Atlasit* (është autor i “Hyrjes”, i pjesës fonetike dhe morfologjike të “Pyetësorit”, i 188 hartave e i simboleve të hartave si dhe bashkautor i sistemit të transkriptimit) etj. Për sa i përket pjesës fonetike të “*Atlasit*”, prej tij janë hartuar pyetjet e fonetikës të “*Pyetësorit*”, që përfshin “65 pyetje dhe 107 nënpyetje (për inventarin e fonemave 29 pyetje dhe 49 nënpyetje, për variantet fonetike të fonemave 8 pyetje dhe 2 nënpyetje, për variantet e fonemave 28 pyetje dhe 54 nënpyetje), 42 harta, dhe pikërisht hartat 1a, 1b, 1c, 1ç, 1d, 1dh, 1e, 2b, 2c, 2ç, 2d, 3, 4, 5, 6a, 6b, 7, 14, 23a, 23b, 25a, 25b, 27a, 27b, 29, 38b/2, 41a, 41b, 42a, 42b, 42c, 42ç, 46, 49b, 50a, 50b, 59a, 59b, 60, 62a, 62b dhe 64”<sup>14</sup>.

Për kategorizimin e dallimeve dialektore fonetike sipas kriterit funksional ai është mbështetur në parimet e N. S. Trubeckoit, të parashtruara në kapitullin “Fonologjia dhe gjeografia gjuhësore” të veprës “*Principe de phonologie*” (Paris, 1949), ku dallimet fonetike të dialekteve ndahen në tri grupe: 1) *dallime fonologjike*, që lidhen me inventarin dhe funksionin e fonemave; 2) *dallime fonetike*, që lidhen me variantet fonetike të fonemave; 3) *dallime fonetike dhe etimologjike*, që lidhen me përbërjen fonemore të një fjale në dialekte të ndryshme<sup>15</sup>.

Por në “*Atlas*” paraqitja është bërë duke ndjekur një skemë binare, sipas së cilës dallimet fonologjike ndahen në fonologjike dhe jofonologjike<sup>16</sup>.

<sup>14</sup> *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), I, Tiranë, 2007, f. 21.

<sup>15</sup> Po aty, f. 20.

<sup>16</sup> Këtë ndarje J. Gjinari e ka zbatuar edhe në klasifikimin e dallimeve morfologjike, duke i ndarë në strukturore dhe jostrukturore. Në dallimet strukturore përfshin dallimet dialektore në inventare strukturash (në kategori gramatikore dhe në forma paradigmash) dhe dallimet në variante strukturash (në forma dhe në morfema), kurse në dallimet jostrukturore fut dallimet në variante fonetike dh ato në denduri përdorimi variantesh.

Në dallimet fonologjike përfshihen dallimet në inventarin e fonemave (sisteme vokalike me 7 zanore /i, y, e, a, o, u, ë/; sisteme me 113 zanore të shkurtra dhe të gjata /ĩ, ψ<, ě, ǎ, ǒ, ů/ e /i:, y:, e:, {:(e:), a:, o:, u:/ dhe sisteme me 18 fonema, 13 fonema gojore /ĩ, ψ<, ě, ǎ, ǒ, ů/, /i:, y:, e:, {:(e:), a:, o:, u:/ e pesë hundore /i~, y~, e~~, a~, u~/ dhe me 27, 28, 29 e 30 fonema bashkëtingëllore; dallimet në sistemet e fonemave (sisteme me një seri fonemash të shkurtra; me dy seri, të shkurtra e të gjata dhe sisteme me tri seri, të shkurtra, të gjata dhe hundore); dallime në funksionin e fonemave (zog ~ zogj, ftohtë ~ ftoft, flutura ~ flutra). Në dallimet jofonologjike përfshihen variantet fonetike (mjajt ~ mjeft) dhe variante etimologjike (man ~ mën, qilim ~ qylym, vera ~ ve~na, emër ~ e~mën, gardh ~ gjardh, glisht ~ gisht)<sup>17</sup>.

3. Historia e gjuhës shqipe ka qenë një fushë tepër e pëlqyer për prof. J. Gjinarin, ku ai mund të kishte dhënë edhe më shumë, po të mos ia kishte kushtuar përpjekjet kryesore dialektologjisë, të cilën arriti ta ngrinte në nivelin e fushave të tjera më të zhvilluara të gjuhësisë sonë, si gramatika e leksikologjia. Këtë interes të tij për historinë e gjuhës shqipe e dëshmon me një varg shkrimesh, për elementet sllave në të folmet veriore të Shqipërisë, për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe, për vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe, për nyjën e prapme të shqipes, për dëshmitë e historisë së gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar etj.

Duke lënë mënjanë shkrimet për çështje të ndryshme historike të shqipes, do të ndalemi në artikujt për zhvillimet historike në sistemin fonetik të shqipes së përbashkët. Ndonëse me problemet e fonetikës historike janë marrë gjuhëtarë si E. Çabej e Sh. Demiraj, me emrat e të cilëve lidhet ndriçimi i aspektit historik të fonetikës së shqipes, ndihmesa me vlerë në këtë fushë kemi edhe nga J. Gjinari, i cili ka botuar një numër artikujsh në revistat gjuhësore këtu e në Prishtinë për diftongjet *ua/ue*, *ie* dhe *ye*, për zhvillimin e grupeve *kl*, *gl*, për zanoret hundore të gegërishtes dhe *ë*-në e theksuar të toskërishtes dhe për ndryshimet në sistemin e fonemave të dialekteve të shqipes.

Në artikullin “Diftongjet *ua/ue*, *ie* dhe *ye* në të folmet e gjuhës shqipe”, pasi jep një pamje të hollësishme të shtrirjes së këtyre diftongjeve në të folmet e ndryshme jugore e veriore të shqipes, autori përpiket të shpjegojë “shkaqet fonetike të zhvillimeve jo të njëjta që muarën ato nëpër të folme të ndryshme, përafërsisht që nga koha kur *uo*-ja u degëzua në *ua/ue* e gjer më

<sup>17</sup> Të dhënat për pjesën fonetike të “Atlasit” janë verifikuar e saktësuar nga vetë prof. J. Gjinari.

soj”<sup>18</sup>. Në përputhje me këtë qëllim, ai shpjegon “kushtet e ndryshme fonetike që në disa të folme shkaktuan zbërthimin e diftongjeve në togje zanoresh, në disa monoftongimin e tyre dhe në disa ruajtjen si diftongje”<sup>19</sup>. Duke saktësuar pohimet e autorëve që janë munduar të shpjegojnë shkaqet e këtyre ndryshimeve ose duke polemizuar me ta. Kështu, shpërnguljen e theksit një rrokje më përpara, ai nuk e sheh si shkak të zbërthimit të diftongjeve në togje zanoresh, sikundër mendonte A. Dodi, po si pasojë e zbërthimit, duke arritur në përfundimin se “diftongjet u zbërthyen në ato të folme, ku nuk u shkurtuan nga gjatësia”, d.m.th. atje ku “vazhduan të shqiptoheshin të gjata”<sup>20</sup>. Një artikull tjetër i ngjashëm, po kësaj here për grupet e bashkëtingëlloreve, merret me zhvillimin e grupeve *kl* e *gl* në të folmet e shqipes.

Një temë sidomos e pëlqyer e rragjimeve historike në fushë të fonetikës së shqipes është ajo e ndryshimeve në sistemin e fonemave të dialekteve të shqipes. Ndër artikujt kushtuar zhvillimeve të sistemeve fonologjike dialektore, më i rëndësishmi është punimi i gjatë “Vështrim i përgjithshëm mbi ndryshimet në sistemin e fonemave të dialekteve të shqipes gjatë historisë së tyre” (1986). Tek asnjë prej gjuhëtarëve tanë apo të huaj që janë marrë me fonetikën historike të shqipes nuk gjejmë ndonjë përpjekje për të shpjeguar se si nga sistemi fonemor i gjuhës mëmë indoevropiane është kaluar në sistemin e fonemave të mëmës së shqipes dhe nga ky në sistemin fonologjik të gjuhës së sotme. Studimet e tyre janë karakterizuar nga atomizmi, d.m.th. nga përpjekja për ndjekjen e zhvillimeve të fonemave të veçanta, pa i parë ato në gji të sistemit dhe në lidhjet me fonemat e tjera të sistemit. Por, sikundër është provuar për gjuhë të tjera, ndryshimet në inventarin e fonemave të një gjuhe janë sistimore, ato kanë të bëjnë me shuarjen ose lindjen e tipareve dalluese korrelative që dallojnë çiftet e fonemave të lidhura prej tyre në seri paralele. Në dallim nga këta autorë, në këtë shkrim të J. Gjinarit bëhen përpjekje për t’i parë ndryshimet në sistem, në dritën e bashkëlidhjeve të tufave të fonemave dhe të tipareve dalluese bashkëlidhëse, duke i shpjeguar lëvizjet në sistemet fonemore me zhdukjen ose shfaqjen e një tipari korrelativ, të cilat janë përgjegjëse për zhdukjen përkatësisht shfaqjen e një serie të tërë fonemash. Në këtë trajtim në frymën e fonologjisë diakronike evropiane duket ndikimi i leximeve të literaturës së huaj gjuhësore, sidomos i veprave themelore si “Principe de phonologie” të Trubeckoit, “Langue et fonction” të A. Martinesë dhe i gjithë literaturës për fonetikën që hynte në bibliotekën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë ose që sigurohej me rrugë të tjera. Kjo provon se, me gjithë mbylljen e vendit dhe

<sup>18</sup> J. Gjinari, *Diftongjet ua/ue, ie dhe ye në të folmet e gjuhës shqipe*, SF, 1968, 1, f. 97.

<sup>19</sup> Po aty, f. 100.

<sup>20</sup> Po aty, f. 101.

ndërprerjen e lidhjeve shkencore me botën, gjuhëtarët tanë i ndiqnin rregullisht zhvillimet në gjuhësinë bashkëkohore, pavarësisht mungesës së kontakteve të drejtpërdrejta dhe kufizimeve të mëdha ideologjike.

4. Në një varg punimesh të tjera, si “Mendime mbi trajtimin e shndërrimeve fonetike në ‘Gramatikën e gjuhës shqipe’” (1969), “Ndërrime tingujsh në gjuhën letrare shqipe” (1971), “Mbi parashtesën *sh-/ç-* të gjuhës letrare shqipe” (1972), “Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare” (1977), si dhe në kreun e ndërrimeve në maketin “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, 1” (1983)<sup>21</sup>, J. Gjinari merret me shqyrtimin e dukurive fonetike të shqipes standarde.

I pari prej këtyre shkrimeve, i botuar si diskutim në revistën “Studime filologjike”, ka për objekt trajtimin e shndërrimeve fonetike në “gramatikën e gjuhës së sotme letrare shqipe”<sup>22</sup>. Në të autori bën një varg propozimesh lidhur me trajtimin e “shndërrimeve fonetike” në veprën që sot e quajmë “Gramatika akademike”, puna për të cilën kishte nisur me diskutimin e kriterëve themelore dhe të disa prej çështjeve më të vështira të morfologjisë së shqipes, si ndarja e foljeve në zgjedhime, ndryshimet e tingujve etj. Në këtë shkrim, veç mendimeve për objektin dhe strukturën e kreut kushtuar dukurive fonetike, me vlerë janë sidomos përcaktimet e dy prej koncepteve themelore të morfonologjisë, ndërrimet morfologjike të tingujve dhe forma bazë e ndërrimit, të cilat nuk i kemi gjetur të trajtuara më parë në literaturën tonë gjuhësore. Autori jep këtë përkufizim të ndërrimeve: “Këmbimet (alternimet) janë zëvendësime fonemash me njëra-tjetrën që nuk kushtëzohen sot fonetiki”<sup>23</sup>. Në këtë mënyrë, për herë të parë bëhet dallimi i ndërrimeve të vërteta nga reflektimet e tingujve të fjalëve të huazuara në gjuhën shqipe (si i *ct* të latinishtes në *ft* në shqipe te *lucta* > *luftë* etj.) apo nga ndryshimet e një tingulli a grupi tingujsh të fjalëve gjatë historisë së një gjuhe (p.sh., kalimi i grupeve *kl, gl* në *q* përkatësisht *gj: klishë* > *kishë, gjuhë* > *gjuhë* etj.), të cilat sidomos në studimet historike quhen gjithashtu alternime, duke shkaktuar jo rrallëherë ngatërime. Nga shembujt që sjell për ilustrim (me përjashtim të shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicion fundor ([elp] elb), që e trajton si ndërrim, autori e bën të qartë se ndërrimet duhen kuptuar si raporte fonemash në format eptimore të një fjale (dal : dole, punova : punuam, bujk : bujq). Për ta saktësuar edhe më tej se ç’kupton me “këmbime”, autori shton se

<sup>21</sup> A. Dodi, J. Gjinari, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare kombëtare shqipe, I* (maket), Tiranë, 1983.

<sup>22</sup> J. Gjinari, *Mendime mbi trajtimin e shndërrimeve fonetike*, në “Gramatikën e gjuhës së sotme letrare shqipe”, SF, 1969, 3, f. 207–211.

<sup>23</sup> J. Gjinari, art. i cit., f. 208.

ato “kanë vlerë gramatikore, dallojnë sot format e ndryshme gramatikore që merr fjala gjatë fleksionit të saj”<sup>24</sup>. Në këtë mënyrë, përkufizimi i këmbimeve dhe saktësimet që bën autori nuk janë larg konceptimit të ndërrimeve në gjuhësinë e sotme si “kundërvënie me vlerë gramatikore midis fonemash ose grupesh të fonemave që zënë të njëjtin vend në strukturën fonemore të alomorfeve të një morfeme”<sup>25</sup>, që zë fill me përkufizimin e Sosyrit të alternimeve, si “një korrespondim midis dy tingujve ose grupeve të caktuara tingujsh që këmbehen rregullisht ndërmjet dy serish formash bashkekzistuese”<sup>26</sup>.

Një koncept tjetër i patrajtuar më parë në gjuhësinë tonë është ai i formës bazë të ndërrimit, i cili është tepër i rëndësishëm për të përcaktuar se cila është gjymtyra e parë e ndërrimit, d.m.th. për të përcaktuar drejtimin e ndërrimit. Autori lidhur me këtë problem thotë: “Në kundërvënien e formave gramatikore të fjalëve dhe formanteve që do të bëhet gjatë përshkrimit dhe shpjegimit të shndërrimeve fonetike prej krahëve të krahasimit do të merren si bazë ato forma, fjalë dhe formante që janë kryesore nga pikëpamja e gjendjes së sotme të gjuhës sonë e jo ato që janë primare historikisht.”<sup>27</sup> Dhe si forma bazë për ndërrimet e shqipes, në sistemin emëror merr të pashquarën (zegël–zegli, punë–puna), numrin njëjës (plak–pleq, mashkull–meshkuj, i madh–të mëdhenj), rasën emërore (bukë–buke, lule–luleje), gjininë mashkullore (i ardhshëm–e ardhshme); në sistemin foljor merr të tashmen (marr–mora, bluaj–blova etj.), e kryera e thjeshtë në krahasim me pjesoren (pata–pasur, dhashë–dhënë), veta e parë njëjës (ose shumës) (marr–merr, bluaj–blova etj.).

Këto koncepte themelore e saktësime, që janë të domosdoshme për një përshkrim adekuat të dukurive fonetike të gjuhës sonë, materializohen në artikullin tjetër “Ndërrime tingujsh në gjuhën letrare shqipe”, që, sikurse thuhet në shënimin përfund faqes, përbënte “variantin e parë të kapitullit përkatës të morfologjisë së tekstit të “Gramatikës shkencore të shqipes”<sup>28</sup>. Në këtë artikull trajtohen shterueshëm “ndërrimet (alternimet) që janë veçori e gjuhës së sotme letrare, ato që bëjnë një normë të përbashkët letrare” dhe që “janë karakteristike vetëm të stilit të plotë të të folurit”<sup>29</sup>. Këtë përshkrim të këtyre dukurive e gjejmë së fundmi në kreun gje gjës të maketit “Fonetika dhe

<sup>24</sup> J. Gjinari, po aty.

<sup>25</sup> R. Memushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1989, f. 53.

<sup>26</sup> F. de Saussure (1916), *Cours de linguistique générale*, Éditions Payot & rivales, Paris, 1967, f. 216.

<sup>27</sup> J. Gjinari, art. i cit., 210.

<sup>28</sup> J. Gjinari, *Ndërrime tingujsh në gjuhën letrare shqipe*, SF, 1971, 3, f. 21.

<sup>29</sup> Po aty.

gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, 1” (1983)<sup>30</sup>. Në to jemi mbështetur edhe ne për përshkrimin e ndërrimeve të fonemave në monografinë “Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme letrare shqipe”<sup>31</sup>.

Që në titullin e këtij artikulli të bie në sy se autori ka hequr dorë nga termat “shndërrim fonetik” e “këmbim” të përdorur në artikullin “Mendime mbi trajtimin e shndërrimeve fonetike...”, duke i zëvendësuar me “ndërrim”, që përdoret prej tij si term gjenerik për të gjitha llojet e ndryshimeve fonetike<sup>32</sup>. Pavarësisht nga ajo se sa ia ka arritur, nuk mund të mos vlerësohen përpjekjet e autorit për përdorimin e termave të përshtatshëm dhe mundësisht shqip për dukuritë fonetike, terminologjia e të cilave edhe sot e gjithë ditën nuk është ngulitur në gjuhësinë tonë.

## BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Universitá degli Studi di Napoli L’Orientale, 2007.
- Beci, B., *Mbi disa veçori fonetike të të folmeve të gjuhës shqipe në përqsasje me gjuhën letrare*, SF, 1982, 4.
- Dodi, A., Gjinar, J., *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare kombëtare shqipe, I* (maket), Tiranë, 1983.
- Gjinari, J., *Dialektet e gjuhës shqipe*, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1989.
- Gjinari, J., *Dialektologjia shqiptare*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988.
- Gjinari, J., *Diftongjet ua/ue, ie dhe ye në të folmet e gjuhës shqipe*, SF, 1968, 1.
- Gjinari, J., *Diskutim rreth kumtesës së A. Dodit “Diftongjet e shqipes së sotme nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike”* në “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, Tiranë, 1965, f. 372–374.
- Gjinari, J., *Mendime mbi trajtimin e shndërrimeve fonetike në “Gramatikën e gjuhës së sotme letrare shqipe”*, SF, 1969, 3, f. 207–211.
- Gjinari, J., *Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare*, SF, 1977, 4, f. 3–28.
- Gjinari, J., *Sistemi i fonemave zanore të dialekteve të gjuhës shqipe*, SF, 1983, 2.

<sup>30</sup> A. Dodi, J. Gjinar, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, I* (maket), 1983.

<sup>31</sup> Shih: R. Memushaj, *Morfonologji e eptimit...*, vep. e cit.

<sup>32</sup> Po aty.

- Harris, Z. S. (1951), *Structural linguistics*, The University of Chicago Press, Chicago & London, 1963.
- Ismajli, R., *Fonemat margjinale të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, Përparimi, Prishtinë, 1973, 5.
- Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, shblu, Tiranë, 2003.
- Memushaj, R., *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1989.
- Saussure, F. de (1916), *Cours de linguistique générale*, Éditions Payot & Rivages, Paris, 1967.

## SUMMARY

### PHONETIC CONTRIBUTIONS OF PROF. DR. JORGGI GJINARI

Prof. Jorgji Gjinari is widely known as the main Albanian dialectologist, but he has also many contributions in other fields of linguistics as well. The dialectological research, at least in the traditional form that it is carried out by Albanian linguists, is multidisciplinary, including the phonetic, morphologic, lexical, and syntactic facets of language. Thus, the phonetic aspect of language, being part and parcel of the dialectal research, requires that the dialectologist not only to be prepared theoretically in the field of phonetics, but also to know deeply the phonological system of the language and of its dialects serving as object of his study. Without this knowledge can't be carried out the field research and the analysis the phonetic system of any dialect. These conditions are fully fulfilled in the dialectological studies of prof. Jorgji Gjinari, comprising his articles, monographs or university textbooks.

He started his scientific career in the field of dialectology, but later on he shifted to the study of the phonetic aspect of dialectal variants and of the standard variant of Albanian. He has treated in his studies the phonological system of dialectal variants of our language in the second part of XX century, some historic phenomena, such as the development of the *kl* and *gl* consonantic groups or of the *ua/ue*, *ie* and *ye* diphthongs, and changes in the phonological system of the two main dialect of Albanian. Besides, he has contributed to the study of the phonological system of the Standard Albanian with a number of papers and monographs on the vocalic and consonantic systems of the Standard, on the similarities and differences between these systems and those of the dialects, and on the alternations of Standard Albanian. In his writings on morphological alternations of the Standard there are elaborated for the first time in our linguistics some theoretical concepts,

---

such as the definition of the alternations, of their basic form etc., on which further morphonological studies of Albanian are based.

Prof. Gjinari's scientific heritage include many papers, but his main works are the monograph "Dialektet e gjuhës shqipe" (The dialects of Albanian), the university textbook "Dialektologjia shqiptare" (The Albanian dialectology), and "Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe" (The Dialectal Atlas of the Albanian Language), of which he has been the main author and chief editor. This work, which is one of the three main works of the Albanian Linguistics of the last century, can be seen as the culmination of the work the prof. J. Gjinari's work in the field of dialectology.

